



Pranuar / Dorezuar Pritshja/Prodato Received/Delivery		20 - 12 2021 / 1		viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMSTOK	6232/2021		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.935/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.935/2021 të datës 16.11.2021 të parashtruar nga ankuesi [] të cilin me autorizim e përfaqësojnë avokatet [] dhe [] nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 20.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për vendosur për ankesën me numër A.nr.935/2021 të datës 16.11.2021 të parashtruar nga ankuesi []

A r s y e t i m

Ankuesi [] i punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, më datë 16.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 360 të datës 14.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.11.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, ndërsa me datë 01.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritor ka

administruar këto prova: Ankesën e datës 16.11.2021 me nr. protokolli 5468/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë n për përgjigje në ankesë e datës 19.11.2021; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Nr.A.nr.1400/18 të datës 10.08.2021; Vendim me Nr.360 të datës 14.10.2021; Autorizimin e datës 19.03.2018; Pliko me Nr. 2004041 të datës 12.11.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 01.12.2021; Kategorizimin nga DMZP/MPB sipas Ligjit për Zyrtarët Publik; Kartelën e Nëpunësit Z.R.; E-mail nga B.H. për V.G i datës 13.10.2021; E-mail nga V.G për B.H. i datës 11.10.2021; E-mail nga A.A. për T.R. i datës 11.10.2021; E-mail nga T.R. për A.A. i datës 05.10.2021; E-mail nga A.A. për T.R i datës 11.10.2021; E-mail nga T.R. për A.A. i datës 05.10.2021; E-mail nga V.G. për A.Z. i datës 04.10.2021; E-mail nga V.G. për A.Z. i datës 24.09.2021; E-mail nga T.R. për A.A. i datës 05.10.2021; E-mail nga V.G. për A.Z. i datës 04.10.2021; E-mail nga V.G. për A.Z. i datës 24.09.2021; E-mail nga V.G. për A.Z. i datës 04.10.2021; E-mail nga V.G. për A.Z. i datës 24.09.2021; Vendim me nr. 360 i datës 14.10.2021; Vendim me nr. 18 i datës 07.02.2018; Vendimin me Nr. 19 të datës 07.02.2018; Akt Emërimit e datës 01.08.2013;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Duke i'u referuar provave të lëndës është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Prishtinë, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me Vendimin me numër protokolli 360 të datës 14.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AME-së, ankuesit i është lejuar kompensimi në lartësinë prej një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit. Kundër këtij Vendimi ankuesi përmes përfaqësuesve me autorizim avokat dhe ka parashtruar ankesë në KPMSHCK-ë, me pretendimet ankimore që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ankuesit ti njeh të drejtën e kompensimit të dy pagave gjithsej prej 792 .00 € dhe tri paga jubilarë në shumën prej 1, 118.00 €.

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 2 paragrafit 4 ku përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike."*, si dhe duke u bazuar në listën për deklarimin e statusit të DMZP-se si organ kompetent për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë, e dorëzuar nga organi i punësimit se bashku me shkresat në përgjigjen në ankesë, Kolegji ka konstatuar se pozita "Zjarrfikës-Vozitës", hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik dhe si rrjedhojë ankuesi nuk e ka statusin e Nëpunësit Civil, kështu që, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe



Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, udhëzon ankuesin se nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.935/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit dhe
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- Arkivit të KPMSHCK-së.